



REPUBLIKA E SHQIPËRISË


KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.18, datë 31.07.2023

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK
SHOQËRISË “LIRIA ENERGJI” SH.P.K**



Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Liria Energji” me adresë Rruga “Eordej” Korçë Qarku Korçë sipas Kontratës së Konkensionit të formës “BOT” Nr. 6004 Rep., Nr. 1756 Kol., të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoriteti Kontraktues) dhe shoqërisë “Thorenex” sh.p.k (Koncesionari) datë 24.05.2013, për ndërtimin e hidrocentraleve “Shpella Poshtë II”, “Shpella Poshtë III”, Kontratën shtesë të koncesionit Nr. 370 Rep., Nr. 176/2 Kol., datë 04. 04.2016 për ndërtimin e hidrocentraleve “Shpella Poshtë II”, “Shpella Poshtë III”, e ndryshuar e ndryshuar, Kontratën shtesë të koncesionit Nr. 1329 Rep., Nr. 429 Kol., datë 10. 5.2022 për ndërtimin e hidrocentraleve “Shpella Poshtë II”, “Shpella Poshtë III”. me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përroit të Zallit (Shpellë), Bashkia Pogradec, Qarku Korçë”.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:
HEC Shpella Poshtë 2



Vendndodhja e veprës së marrjes 1 (Diga) Përroi i Shpellës (Zallit)

- X= 537803.5; Y= 4530697; Z= 931 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.6 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.172 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.04 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.022 m³/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 1' (e ndërtuar) Përroi i Qysekut

- X= 536156; Y= 4530190; Z= 1040 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.14 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.554 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.14 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.09 m³/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 2 (e ndërtuar) Përroi i Zallit

- X= 536174; Y= 4530052; Z= 1030 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.74 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.74 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.176 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.07 m³/s

Vendndodhja e godinës së Centralit

- X= 538391.4; Y= 4531192; Z= 720 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 1.48 m³/s
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 11.853.000 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 4530 kw
- Vlera totale e investimit: 296,863,017 lekë me TVSH.

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH), ku kanali i largimit të godinës së HEC-it Shpella Poshtë 2 takon trupin ujqor pritës.

X= 538424.32; Y= 4531186; Z= 718 m.m.n.d. (KRGJSH)

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

MAJLINDA PERRIU

